



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.1183/1 Prot.

Shkodër, më 05.02.2020

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

e.mail: _____

Në përgjigje të kërkesës suaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me e.mail me datë 20.01.2020 dhe rregjistruar me nr.1183 prot, datë 21.01.2020, dhe administruar me datë 23.01.2020, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkon informacion, ju bëjmë me dije se:

Të dhënat e Koordinatorit për të Drejten e Informimit mund ti gjeni në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Per_kerkesat_per_informim_1097_1.php

Listën emërore të përditësuar të nëpunësve të Bashkisë Shkodër me funksionet e tyre si dhe adresat e postës elektronike sipas drejtorive, do ti keni bashkangjitur. Nëpunësit nuk disponojnë numër telefoni për përdorim zyrtar.

Rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave, mund ta gjeni në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/rregullore_per_parandalimin_e_konfliktit_te_interesave_ne_ushtrimin_e_funksioneve_publike_2507.pdf. Bashkangjitur do të keni dhe autorizimin tip i cili është firmosur nga nëpunësit e Bashkisë Shkodër.

Në strukturën administrative të Bashkisë Shkodër, ekzistojnë lidhje familjare mes nëpunësve të saj, por deri më tani nuk ka raste të iniciuara të konfliktit të interesit, në ushtrim të detyrave funksionale.

Përsa ka informacion dhe dokumentacion nga dosjet e personelit dhe dokumentat e sjella nga punonjësit, nuk rezultojnë të ketë nëpunës të përfshirë në krime kundër njerëzimit apo që gjatë periudhës 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991 të kenë pasur pozicionet që citoni në kërkesë.

Titujt e nderit të dhënë nga Këshilli i Bashkisë Shkodër, do ti keni bashkangjitur kësaj shkrese.

Bashkia Shkodër është në procesin e përfundimit të evidentimit të plotë të lapidarëve, memorialeve, monumenteve, pllakave përkujtimore në të gjithë territorin e saj. Brenda një periudhe të shkurtër, do ju dërgojmë dhe listën e plotë të tyre. Informacion për muzetë e qytetit mund të gjeni duke klikuar në

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Muzeumet_312_1.php

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Muzeumet_239_1.php

Një muze tjetër i qytetit është dhe “Vendi i dëshmisë dhe kujtesës”, i cili ndodhet në bul. “Skenderbeg”, nr.26, Shkodër.

Listën me emërtimet e rrugëve, shesheve, ndërtesave mund ta gjeni duke klikuar në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet_e_Keshillit_169_1.php dhe mund ta shkarkoni duke vendosur numrin e vendimit dhe datën e miratimit të tij, respektivisht VKB nr.11, datë 15.02.2007 “Mbi miratimin e emertesave të reja të shesheve, rrugëve dhe institucioneve të qytetit të Shkodrës”, VKB nr.44, 45, 46 dhe 47, datë 24.06.2019 “Për emërtimin e rrugëve në njësitë administrative Shalë, Shosh, Pult dhe Dajç”. VKB nr.117, datë 24.11.2009 “Për miratimin e rrugëve të paemertuara dhe shesheve të qytetit”, për arsye të madhësisë do e dërgojmë me We Transfer. Informacion mund të gjeni dhe në <https://geoportal.asig.gov.al/map/?auto=true>, respektivisht tek sistemi i adresave dhe infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare.

Qyteti i Shkodrës, ka vetëm një varrezë dëshmorësh ndodhur në aksin rrugor Shkodër – Rrencë. Bashkangjitur do të keni dhe listën emërore të dëshmorëve të LANÇ.

Bashkia Shkodër, nuk është institucioni që duhet të ketë të dhëna për listën e të burgosurve dhe të përndjekurve politikë si dhe të veteranëve të luftës. Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, në Bashkinë Shkodër ndodhet “Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Integritit të ish të Përndjekurve Politikë” me status pasiv që nga viti 2017 dhe me kryetar Zenel Drangu. Adresa e saj është rruga “13 dhjetori”, nr.1, Shkodër. Në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nuk ka të dhëna të regjistruara për shoqata të veteranëve të luftës.

Duke ju uruar mbarëvajtje në punë.

KRYETAR

Voltana ADEMI

Me vendim delegimi

Zv/Kryetar

Emilia KOLIQI